



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 21.14.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË MINISTRISË PËR
KOMUNITETE DHE KTHIM
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshëm Emine Fazliu e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Mehmet Muçaj (udhëheqës i ekipit), Natyra Kasumaj dhe Muharrem Qyqalla (anëtar ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Florim Beqiri.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	18
5 Qeverisja e mirë.....	19
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	22
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	25

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 09.11.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Ministrisë, për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes


Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

Theksim i Çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj në faktin se vlera e pasurive kapitale, e shpalosur në PFV ishte e mbivlerësuar. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos bartjes (fshirjes nga regjistrat) së pasurive kapitale të investuar nga ministria te komunat dhe përfituesit të tjerë të cilët janë pronarë i këtyre pasurive.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Ministrit- auditimi 2017**

Ministri brenda afatit ligjor prej 15 ditëve kalendarik nuk ka konfirmuar nëse pajtohet apo ka komente në draft raportin e auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e ministrisë. Ne kemi analizuar veprimtarinë e ministrisë se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

Te neni 19.3.1 - Pasuritë kapitale mbi 1,000€, nuk janë të plota dhe të sakta për faktin se 6 projekte në vlerë 325,196€, të regjistruar në SIMFK edhe pse ishin finalizuar nga ministria në vitin 2017, nuk ishin shlyer nga regjistri i pasurive të MKK-së. Këto pasuri duhej të transferohen te komunat dhe përfituesit të tjerë të cilët janë pronarë i këtyre pasurive. Pasurit e finalizuara dhe të pa transferuara janë: Projekti i ndërtimit të shtëpive në Komunën e Gjakovës në vlerë 131,889€, Projekti për Instalimin e kamerave në Komunën e Shtërpcës në vlerë 92,923€, Projektin për Instalimin e kamerave në Komunën e Novobërdës në vlerë 59,726€;; Projekti për kishën e Shën Nikollës në Prishtinë në vlerë 20,637€;; Projekti Ndërtimi i Qendrës Rinore në Osojan të Komunës së Istogut 16,026€ dhe Projekti i Ndërtimit për ballon sallës në Komunën e Kamenicës në vlerë 3,995€.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Sekretari i Përgjithshëm i MKK -i është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Ministri është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Ministrisë.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga MKK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr.01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFPP-së nr. 03/L-048 i ndryshuar me Ligjin nr. 03/L- 221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194;
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Raporte tre mujore duke përfshirë edhe pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Raportimet për obligimet e papaguara; dhe
- Planifikimin e prokurimit dhe raportin e kontratave të nënshkruara.

Në PFV përveç mosprezantimit të saktë të pasurive të cilat kanë ndikuar në theksim të çështjes ekzistoj edhe dobësitë e më poshtme:

- Në nenin 18 Detyrimet kontingjente - nuk ishte prezantuar asnjë vlerë përderisa vlera e tyre ishte 4,057€; dhe
- Në nenin 19.3.2 Pasuritë jo-kapitale (me vlerë nën 1,000€) - ishin nënvlerësuar. Pasuritë e prezantuara në PFV ishin 32,205€ ndërsa sipas sistemit të e-pasurisë ishin 51,163€. Për më tepër, 4 pagesa në vlerë 9,739€ (blerja e telefonave mobil - 8,000€ dhe furnizim me mobile - 1,739€) nuk ishin regjistruar në sistemin e e-pasurisë.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë përveç shpalosjeve.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Ministri duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime konkrete lidhur me projektet kapitale të cilat janë finalizuar nga MKK. Ato projekte duhet të largohen nga regjistri i pasurive të ministrisë dhe të barten te përfituesit e caktuar. Po ashtu, duhet të siguroj regjistrimin e të gjitha pasurive jo kapitale në regjistrat adekuat.

Rekomandimi 2 Ministri duhet të shtoj kontrollet në mënyrë që detyrimet kontingjente të raportohen dhe shpalosen drejtë në PFV. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në MKK. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore si dhe pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet në disa fusha të shpenzimeve kërkojnë përmirësim të mëtejshëm për të parandaluar shpenzimet jo racionale. Fushat kryesore ku nevojiten më shumë përmirësime janë planifikimi i buxhetit, prokurimi, menaxhimi i pasurive, klasifikimi i duhur i shpenzimeve, dhe menaxhim më racional i subvencioneve.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Në kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	7,857,516	4,631,607	4,566,688	7,678,676	7,107,326
Granti i Qeverisë -Buxheti	7,857,516	4,631,607	4,566,688	7,678,676	7,107,326

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 3,225,909€. Zvogëlimi i buxhetit është shkaktuar me Vendimin e Qeverisë nr. 08/151 të datës 02.08.2017.

Në vitin 2017, MKK ka shpenzuar 98.6% të buxhetit final ose 4,566,688€, me një rritje prej 7.6% krahasuar me vitin 2016.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	7,857,516	4,631,607	4,566,688	7,678,676	7,107,326
Pagat dhe Mëditjet	755,710	772,801	772,801	752,433	657,233
Mallrat dhe Shërbimet	375,652	385,652	344,740	339,439	351,629
Shërbimet komunale	26,154	13,154	9,745	17,987	12,643
Subvencionet dhe Transfere	300,000	300,000	290,000	299,993	268,877
Investimet Kapitale	6,400,000	3,160,000	3,149,402	6,268,824	5,816,944

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar për paga dhe mëditje ishte rritur për 17,091€. Rritja e buxhetit ishte bërë me vendim të Qeverisë si rezultat i rritjes së numrit të punëtorëve për gjashtë punonjës me rekomandimet e dala nga bisedimet e Brukselit;
- Për kategorinë mallra dhe shërbime buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar ishte rritur për 10,000€. Kjo rritje është me rishikim të buxhetit ku mjetet nga shërbimet për komunalë ishin bartur në mallra dhe shërbime;
- Planifikimi i përgjithësuar dhe i dobët i projekteve kapitale në kategorinë e investimeve kapitale ka ndikuar që Qeveria të reduktoj mjetet për 3,240,000€ në këtë kategori ekonomike.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

Çështja 3 – Planifikimi i projekteve kapitale

- E gjetura** MKK nuk kishte bërë planifikim të mirë të projekteve kapitale. Në tabelën 3.2 të projekteve kapitale të ligjit të buxhetit ishin planifikuar tri² projekte kapitale, këto projekte nuk ishin specifikuar dhe detajuar por kishin vetëm një përshkrim të përgjithshëm me vlera financiare. Si rezultat i planifikimeve jo të mira MKK-së ju kishte zvogëluar buxheti për investime kapitale.
- Rreziku** Planifikimi jo i mirë i projekteve kapitale nuk ofron një pasqyrë të qartë për projektet të cilat priten të realizohen dhe rrit rrezikun e mos arritjes së objektivave të ministrisë.
- Rekomandimi 3** Ministri duhet të siguroj se gjatë procesit të planifikimit të projekteve kapitale bëhet një vlerësim i mirëfilltë duke planifikuar dhe specifikuar saktë të gjitha projektet që do të realizohen gjatë vitit.

3.2 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. MKK për vitin 2017 kishte planifikuar 772,801€ për kategorinë paga dhe mëditje ndërsa kishte shpenzuar 772,801€.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.3 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me rekrutimin, mbulimin e pozitave me UD, kontratat, trajnimet, pushimet etj. Ne testuam një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarra në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Nga testimet e bëra ka rezultuar çështja në vijim:

² Projekti RRR –IV, Projekti për Kthim (ndërtimi i shtëpive për të kthyerit dhe Projekti për Komunitete

Çështja 4 - Pozitat me Ushtrues Detyre

- E gjetura** Ligji për Shërbimin Civil nr.03-L-149, përcakton se një pozitë nuk mund të mbahet nga ushtruesi i detyrës për më shumë se tre (3) muaj.
- Ne kemi identifikuar se pozita e Sekretarit të Përgjithshëm vazhdon të mbulohet me ushtrues detyre që nga viti 2013 si dhe pozita e Drejtorit të Departamentit për Politika dhe Analiza vazhdon të mbulohet me ushtrues detyre nga viti 2014.
- Rreziku** Mbulimi i pozitave të rëndësishme me ushtrues detyre për një kohë të gjatë, rrit rrezikun e mos arritjes së objektivave dhe performanca/përgjegjësia e realizuar në këto pozita të mos jetë në nivelin e duhur.
- Rekomandimi 4** Ministri duhet të marrë masa të menjëhershme që për pozitat të cilat mbulohen me ushtrues detyre bëhet një zgjidhje e qëndrueshme me pozita të rregullta në pajtim me kërkesat ligjore.

3.4 Mallrat dhe shërbimet si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe komunali ishte 398,806€. Prej tyre ishin shpenzuar 354,485€. Ato kanë të bëjnë me shpenzimet për furnizim me material zyrtar, shërbime kontraktuese, shërbime komunale, udhëtime zyrtare, shërbime të mirëmbajtjes etj. Nga testimet tona identifikuam çështjet si në vijim:

Çështja 5 - Dobësi gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit

- E gjetura** Sipas nenit 28 të LPP-së pika 7 - Autoriteti kontraktues nuk do të përpilojë specifikimet teknike që i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenje dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi.
- Te lënda "Furnizim me pajisje të IT", në vlerë 9,805€ në dosjen e tenderit përkatësisht në njoftimin për kontratë MKK kishte specifikuar artikullin duke e përcaktuar prodhuesin Samsung Galaxy tab. S10.5.
- Rreziku** Përcaktimi i specifikimeve teknike që i referohen një prodhimi specifik apo shenje dalluese rrit rrezikun e favorizimit ose diskriminimit të operatorëve ekonomik.
- Rekomandimi 5** Ministri duhet të siguroj se në specifikacionet teknik nuk do të vendosen prodhime specifike apo shenja dalluese të një artikulli.

Çështja 6 - Mangësi në procedimin e pagesave

- E gjetura** Sipas Rregullës nr. 01/2013 për Shpenzimin e Parasë Publike, fillimisht duhet të procedohet zotimi i mjeteve, lëshohet urdhër blerja, dhe pas pranimit të blerjeve bëhet raporti i pranimit, si dhe pranohet fatura. Në dy pagesa për mallra dhe shërbime kemi identifikuar se zotimi dhe urdhër blerja ishte bërë pas pranimit të faturës.
- E gjetura** Mos ndjekja e procedurave të duhura të kontrollit gjatë pranimit të mallit dhe kryerjes së pagesave mund të ndikojë në pranimin e mallrave që nuk janë në pajtim me kushtet e kontraktuara dhe pagesa potencialisht të parregullta.
- Rekomandimi 6** Ministri duhet të iniciojë një rishikim të brendshëm dhe të ndërmerri masat e duhura për të siguruar që dështimet e ngjashme nuk do të ndodhin në të ardhmen.

Çështja 7 - Përdorimi i veturave zyrtar

- E gjetura** Paragrafi 3.3 i nenit 3 të UA për përdorimin e veturave zyrtare nr. 03/2008 përcakton se - “në raste të caktuara, nëpunësve të caktuar, për shkak të specifikave të posaçme të punës, me vendim të ministrit, mund t’u lejohet përdorimi i automjeteve zyrtare edhe jashtë orarit zyrtar të punës me propozim të sekretarit të përhershëm”.
- Kemi identifikuar se 5 zyrtar të MKK me vendim të ministrit i shfrytëzojnë veturat zyrtare 24h pa pasur punë specifike zyrtare.
- Rreziku** Vendimi për lejimin e shfrytëzimit 24h të automjeteve zyrtare nga personeli për qëllime private mund të ndikon në dëmtimin e buxhetit të ministrisë.
- Rekomandimi 7** Ministri duhet të rishikojë vendimet për lejimin e shfrytëzimit 24h të automjeteve zyrtare nga stafi i ministrisë dhe ato të lejohen vetëm në raste specifike siç e parasheh udhëzimi.

3.5 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 300,000€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 290,000€. Ato kanë të bëjnë me subvencionimin e OJQ-ve, asistencën e komuniteteve etj.

Çështja 8 - Mangësi në monitorim të subvencioneve

E gjetura

Nga testimet tona identifikua çështjet si në vijim:

- Me 28.03.2017, MKK kishte nënshkruar një marrëveshje me OJQ Future Without Fear në vlerë 9,980€, për realizimin e projektit “Barazia Gjinore në Shtëpçë”. Ky projekt është paraparë të përfundoj brenda 5 muajve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes. Deri sa ne ishim në auditim (prill 2018), ky projekt ende nuk ishte realizuar nga OJQ.
- Në pagesën 14,700€ që ndërlidhet me subvencionimin me dru për nevoja të komunitetit ne identifikua se ishin paguar 395.9 m³ ndërsa janë pranuar 388 m³ dru dhe shndërruar në vlerë financiare kemi një gabim financiar për 293€³ (7.9m³*37.13€).

Rreziku

Mos realizimi i projektit brenda afatit të përcaktuar rritë rrezikun që projekti të mos realizohet fare dhe ndikon që të mos arrihet qëllimi i caktuar. Po ashtu, kontrolli i dobët gjatë procedimit të lëndëve për pagesë ka ndikuar që të bëhen pagesa më shumë se sa që ishin pranuar mallra.

Rekomandimi 8

Ministri duhet të siguroj që projekti të realizohet sipas marrëveshjes së planifikuar në mënyrë që subvencionin të arrij objektivat e caktuara si dhe të forcoj kontrollet në të gjitha nivelet gjatë procedimit të pagesave.

³ MKK kishte përdorur kontratën publike kornizë të Autoritetit Qendror Prokurimit për furnizim me dru ku çmimi për m³ ishte 37.13 euro.

3.6 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 3,160,000€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 3,149,402€. Ato kanë të bëjnë me projektet për komunitete, projektin për kthim dhe integrim të komuniteteve dhe projekti për ndërtim për të kthyerit. Gjatë auditimit kemi rishikuar disa procedura të prokurimit për investime kapitale dhe identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja 9 - Sigurimi i tenderit jo në harmoni me kërkesat ligjore

E gjetura Sipas nenit 57, pika 3 të LPP-së, - Nëse autoriteti kontraktues vendos që të detyrojë depozitim të sigurisë së tenderit, shumën e sigurisë së tillë duhet të jetë jo më pak se 1% dhe jo më shumë se 3% e vlerës së parashikuar të kontratës publike ose konkursit të projektimit, por sidoqoftë, në asnjë rast nuk duhet të jetë më pak se 1,000€.

Në projektin “Ndërtimi dhe renovimi i shtëpive për të kthyerit” me vlerë të parashikuar prej 6,000,000€, sigurimi i kërkuar i tenderit ishte 4,000€, e jo së pak 1% e vlerës së parashikuar të kontratës ashtu siç kërkohet. Shprehur në vlerë monetare do të duhej të ishte 60,000€.

Rreziku Mos sigurimi i tenderit sipas kërkesave ligjore pamundëson autoritetin kontraktues të marrë siguri nëse operatorët ekonomik qëndrojnë mbrapa ofertave të dorëzuara.

Rekomandimi 9 Ministri duhet të sigurojë se stafi përgjegjës ndjekin udhëzimet e kërkuara për përgatitjen e dosjes së tenderit dhe kushteve të kontratës në pajtueshmëri me kërkesat ligjore.

Çështja 10 - Paramasa dhe parallogaria

E gjetura Për kontratat publike kornizë, neni 38 i LPP parasheh “Autoriteti kontraktues do të specifikojë në dosjen e tenderit vlerën ose sasinë e kontratës si një prag apo një tavan dhe do të lejojë devijim prej tij duke deklaruar gjithashtu përqindjen e mospërputhjes së lejuar. Mospërputhja e lejuar nuk mund të jetë më e lartë se plus/minus tridhjetë përqind (30%)”. Nëse urdhërblertet tejkalojnë sasinë totale indikative ose vlerën totale indikative të kontratës publike kornizë (duke përfshirë +/- tridhjetë përqind (30%)), pa marrë parasysh datën origjinale të skadimit të Kontratës Publike Kornizë, kontrata do të ndërpritet automatikisht.

MKK në vitin 2017 kishte lidhur kontratë kornizë për “Furnizim me material ndërtimor” për periudhën 3 vjeçare në vlerë 3,461,554€. Edhe pse kjo kontratë ka vlefshmëri edhe për dy vite tjera dhe nuk ishte tejkaluara vlera totale indikative e kontratës kemi vërejtur se disa pozicione ishin tejkaluara jashtëzakonisht shumë si:

- Pozicioni 1.1 për furnizim me lëndë druri - sasia e parashikuar indikativë ishte 10,500 m ndërsa ishin realizuar dhe paguar 71,484 m;
- Pozicioni 1.17 për furnizim me lëndë druri ishin kontraktuar sasi 1,150 copë ndërsa ishin realizuar 11,431 copë;
- Pozicioni 5.37 për furnizim me tjegulla ishin kontraktuar 18,000 copë ndërsa ishin realizuar 399,481 copë.

Tejkalimi i sasive indikativë ndikohet nga paramasa dhe parallogaria e dobët. Vlen të theksohet se deri në fund të vitit 2017 kjo kontratë shprehur në vlera financiare ishte realizuar 2,802,692€.

Rreziku Fakti që disa pozicione janë tejkaluara ekstremisht shumë gjatë vitit të parë rrit rrezikun që pozicionet tjera të parapara mos të realizohen.

Rekomandimi 10 Ministri duhet të shtoj kontrollin me rastin e përgatitjes së paramasës dhe parallogarisë duke siguruar se sasinë indikativë do të përcaktohen duke u bazuar në nevojat reale për furnizime. Më tutje, për tu siguruar se kontrata është duke u implementuar ashtu siç ishte paraparë ministri duhet të siguroj monitorimin e vazhdueshëm të kësaj kontrate.

3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurisë mbi 1,000€ e prezantuar në PFV e vitit 2017 është 3,273,553€ ndërsa vlera e pasurisë nën 1,000€ ishte 32,205€. Mangësitë e evidentuara lidhur me menaxhimin e pasurive i kemi prezantuar te kapitulli i PFV-ve.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016 të MKK-it ka rezultuar me 16 rekomandime. Menaxhmenti ka zbatuar kërkesat për të hartuar një plan veprimi brenda 30 ditëve pas pranimin të raportit të auditimit për vitin 2016 të ZKA-së. Edhe pse është hartuar plani i veprimit, MKK nuk kishte formuar ndonjë komision për të monitoruar zbatimin e tyre. Raporti ynë i auditimit për PFV e MKK për vitin 2016, nuk është diskutuar nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Deri në fund të auditimit tonë, për vitin 2016, nëntë rekomandime janë zbatuar, tri ishin në proces të zbatimit dhe katër nuk janë adresuar ende. Po ashtu, nga viti 2015 ishin bartur edhe pesë rekomandime (të pa zbatuara dy dhe tre ishin në zbatim e sipër). Gjendja e këtyre rekomandimeve në vitin 2017 ishte: dy të zbatuara, një pjesërisht dhe dy nuk janë zbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 11 - Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak dhe viti i mëhershëm

- E gjetura** Për shkak të menaxhimit jo të mjaftueshëm të procesit dhe mungesës së një monitorimi formal për mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të AP, një pjesë e rekomandimeve të vitit të kaluar dhe atyre të bartura më herët janë zbatuar. Edhe pse është hartuar plani i veprimit, MKK nuk kishte monitoruar zbatimin e tyre.
- Rreziku** Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve në sistemet financiare kanë rezultuar në planifikim të dobët të projekteve kapitale, pozitat me ushtrues detyre, monitorim jo i mirë i subvencioneve, dhe menaxhim i dobët i pasurive.
- Rekomandimi 11** Ministri duhet të siguroj që është zbatuar plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Lidhur me qeverisjen brenda MKK veçanërisht në lidhje me llogaridhënien, menaxhimin e rrezikut dhe cilësinë e raportimit menaxherial ne konsiderojmë se MKK kishte bërë raportime të rregullta gjatë vitit 2017 duke i përgatitur PFV me kohë, përveç kësaj kishte përgatitur pyetësorin e vetëvlerësimit me kohë si dhe kishte hartuar listën e rreziqeve me të cilët përballet ministria. MKK e ka strategjinë 2014-2018 e cila për tu realizuar ka edhe kosto financiare.

Kemi vlerësuar se MKK ende ka mungesë të zbatimit të plotë të rekomandimeve të cilat ndikojnë, në qeverisje dhe në vlerë të dobët për paranë. Pyetësori i vetëvlerësimit edhe pse është hartuar nuk ishte përcjellë me dëshmitë e mjaftueshme. Auditimi i Brendshëm me punën e tij nuk është duke i kontribuar sa duhet menaxhmentit në përmirësimin dhe forcimin e kontrolleve të brendshme. Më tutje, ekziston një numër i dobësive të qeverisjes brenda MKK-së veçanërisht në lidhje me prokurimin. Mungesa e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve dhe i operimit të një sistemi cilësor i auditimit të brendshëm, nuk janë në nivelin e duhur. Komiteti i auditimit edhe pse është i themeluar dhe kishte mbajtur katër takime, nuk ishte efektiv për të promovuar raportet e auditimit të brendshëm.

Zinxhiri llogaridhënës në MKK, përfshirë Sekretarin e Përgjithshëm, Drejtori i departamentit për politika dhe analiza, mbahen nga ushtrues të detyrës. Këto pozita mbahen si UD në periudhë më të gjatë se një vit. Më tutje, përdorimi i veturave zyrtare në pesë raste nuk është duke u përdorur sipas Udhëzimit për Përdorimin e Veturave Zyrtare 03/2008, sepse veturat zyrtare këta persona me vendim të ministrit i shfrytëzojnë 24 orë.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me tre anëtarë të stafit - Drejtori i NjAB dhe dy auditor. Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) për 2017 kishte planifikuar dhe realizuar shtatë raporte të auditimit.

Çështja 12 – Funksionimi i dobët i NjAB

E gjetura	Ekzistojnë një numër dobësish në lidhje me operacionet aktuale të NjAB-së, si: <ul style="list-style-type: none">• Tri raporte të auditimit kanë mbuluar aktivitetet të cilat kishin fokus vitin 2016;• Dokumentim i pa mjaftueshëm i të gjeturave: në divizionin e personelit AB kishte shënuar se disa zyrtare të ministrisë kanë shfrytëzuar pushimin mjekësor dhe nuk i kanë sjell vërtetimet mjekësore ndërsa në gjatë rishikimit kemi vërejtur se për ato raste kishte vërtetime mjekësore; në departamentin për monitorim dhe menaxhim të projekteve AB ka potencuar se në projektin Renovimi i kishës Shën Nikolla është lejuar punë shtese 10% ndërsa në gjatë rishikimit kemi vërejt se nuk ishte lejuar punë shtesë;• Rishikimet e auditimit të brendshëm nuk kanë trajtuar projekte për investime kapitale në vitin aktual; dhe• Komiteti i auditimit nuk ka përgatitur raport përfundimtar për menaxhmentin e lartë lidhur punën e NJAB-it.
Rreziku	Auditimi i brendshëm nuk kishte ofruar sigurinë e duhur mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme. Mungesa e kontributit të pritur nga NJAB rritë rrezikun që sistemi i kontrollit të brendshëm të mos përmirësohet.
Rekomandimi 12	Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Ministri duhet të sigurojë se Plani i NJAB mbështetet në fushat me rrezik dhe ndihmon aktivitetet operative në vazhdim.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti ka dizajnuar sisteme të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar, përfshirë strukturën organizative dhe linjat e llogaridhënies. Sekretari i Përgjithshëm mban takime të rregullta javore me Drejtor të Departamenteve. Për këto takime përgatiten procesverbale ku pasqyrohen aktivitetet e ndryshme operative.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
Vlerësimi i rrezikut	Ministri duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një drejtor përkatës dhe të sigurojë monitorim të rregullt dhe raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.		Është hartuar regjistri por nuk janë identifikuar masa që do të ndërmerren në raste të ballafaqimit të rreziqeve.	
Prokurimi	Ministri duhet të sigurojë që janë forcuar kontrollet në procesimin e realizimit të pagesave respektivisht të ndjekin të gjitha hapat e pagesave sipas rregullave të thesarit.			I pa zbatuar
Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se behet një analizë e arsyeve për mos regjistrimin e plote të pasurisë dhe të siguroj se ky regjistër është plotësuar me informata të nevojshme. Procesi i inventarizimit duhet të përfundohet para përgatitjes së PFV. Me tutje të gjitha investimet e bëra për komunat dhe komunitetin duhet të barten të përfituesit si pasuri jo financiare.			I pa zbatuar

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Pasqyra Financiare Vjetore	Ministri duhet të sigurojë që të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për Theksimin e Çështjes. Në këtë aspekt, duhet të ndërmerren veprime për adresimin e shkaqeve në mënyre sistematike dhe praktike për t'i eliminuar gabimet në regjistrimin pasurive kapitale, për të siguruar regjistra të saktë të pasurive në posedim të Organizatës; dhe			I pa zbatuar
PFV	Ministri duhet të sigurojë se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar se informatat e raportuara për menaxhmentin dhe palët tjera të interesit të rishikohen në mënyrë kritike para se ato të dorëzohen, me qëllim të evitimit të kësaj dukurie. Plani final i procedurave të prokurimit duhet t'i përfshijë të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit të ri fiskal.	I zbatuar		
Qeverisja	Ministri duhet të sigurojë që të zbatohet plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, në bashkëveprim me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.			Plani i veprimit edhe pse është hartuar ai nuk ishte rishikuar gjatë vitit dhe si i tillë nuk kishte përcaktuar afatet kohore për zbatim të rekomandimeve.

Pyetësi i vetëvlerësimit	Ministri duhet të sigurojë që të rishikohet plotësimi i pyetësit të vetëvlerësimit dhe të bëhet adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësit të vetëvlerësimit dhe për ta siguruar dokumentacionin mbështetës.		Pyetësi i vetëvlerësimit ishte plotësuar por nuk kishte dëshmi adekuate siç kërkohej në formularin e pyetësit.	
Rishikimet specifike të qeverisjes-	Ministri duhet t'i shqyrtojë shkaqet e mos aplikimit të kontroleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë eliminimin e dobësive në procesin e shpenzimeve dhe raportimit.	I zbatuar		
Paga dhe Mëditje	Ministri duhet të sigurojë që procedurat e rekrutimit fillojnë më kohë, dhe kohëzgjatja e funksionit si ushtrues detyre të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar më Udhëzimin Administrativ.			I pa zbatuar
Paga dhe Mëditje	Ministri duhet të forcojë kontrollet në menaxhimin e procedurave të personelit në mënyrë që të gjithë të punësuarit t'i plotësojnë kriteret e përcaktuara në përshkrimin e vendit të punës për pozitat përkatëse.	I zbatuar		
Mallra dhe shërbime	Ministri të sigurohet se janë duke u zbatuar kërkesat ligjore në lidhje me shpenzimin e parasë publike për kategori. Mjetet e ndara për nevoja të brendshme të organizatës të shfrytëzohen vetëm për këtë qëllim të përcaktuar.	I zbatuar		

Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të sigurojë se në buxhetin e viteve në vijim në kategorinë paga dhe mëditje të përfshihen pagat të gjithë të punësuarve të nevojshëm, përfshirë edhe pagat retroaktive. Me pas, çfarëdo kompensimi në lidhje me shtesat ndaj punonjësve, të paguhen vetëm nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.	I zbatuar		
Mallra dhe shërbime	Ministri duhet të sigurojë kontrolle shtesë në menaxhimin e procedurave deri në lidhjen e kontratave. Operatorët fitues të tenderit, para nënshkrimit të kontratës duhet t'i plotësojnë të gjitha kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit.	I zbatuar		
Subvencione dhe Transfere	Ministri të ndërmarrë veprimet e nevojshme që të sigurojë se subvencionet realizohen në përputhje me rregulloren e brendshme për ndarjen e subvencioneve për OJQ-të, duke iu përmbajtur kushteve dhe kriterëve të caktuara me marrëveshje.		Subvencionet janë dhënë duke i plotësuar kriteret ndërsa në një rast nuk ishte sjellur raporti që ndërlidhët me projektin për të cilin është marr subvencioni.	
Investime Kapitale	Ministri duhet të sigurojë se lidhja e marrëveshjeve të bashkë financimeve të behet përmes një procesi të rregullt ligjor duke specifikuar të gjitha kriteret të cilat ofrojnë siguri të mjaftueshme për realizimin e projekteve. Me tutje, t'i forcoj kontrollet mbi mbikëqyrjen e procesit të ekzekutimit përmes raporteve periodike narrative dhe financiare të mbështetura me dëshmi adekuate, të cilat dëshmojnë shpenzimet e krijuara.	I zbatuar		

Çështje te përbashkëta	Ministri të duhet të rishikojë arsyet për dështimin e kontrolleve dhe të marrë masa dhe veprime për forcimin e tyre, në mënyrë që të gjitha aktivitetet e prokurimit të zhvillohen në përputhje të plotë me kërkesat e LPP-së.	I zbatuar		
Çështje te përbashkëta	Ministri duhet të rishikojë arsyet e vazhdimësisë së mangësive në procedimin e pagesave dhe të sigurojë zbatimin e kontrolleve efektive në këtë fushë. Të sigurojë se është bërë ndarja e duhur e detyrave, që faturat pranohen dhe protokollohen në zyrën e arkivit, e me pastaj të shpërndahen në njësitë përkatëse.		MKK gjatë vitit 2017 ka protokolluar faturat e pranuar ndërsa lidhur me procedimin e pagesave nuk kemi ndonjë ndryshim nga viti i kaluar.	
Pasuritë	Ministri duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese në këtë fushë, dhe të ndërmerren veprimet e duhura për përmirësimin e menaxhimit të tyre. Në rast nevojë zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit për menaxhimin e pasurisë.			I pa zbatuar
Pasuritë	Ministri të sigurojë se janë marrë masat për ndalimin e përdorimit të veturës zyrtare, personit që nuk është punonjës i ministrisë. Të rishikojë vendimet për stafin që nuk ka të drejtë përdorimi 24h të veturave zyrtare dhe të sigurojë se raportimi mbi shfrytëzimin e veturave të jetë i plotë.	I zbatuar		